



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.44, datë 29.04 2020

**“PËR  
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 108, DATË 25.10.2019 TË KËSHILLIT  
BASHKIAK”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b” dhe 1.2, shkronjat “a” dhe “c”, nenit 54, shkronja “e/1”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 113 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Vendimit nr. 285, datë 21.05.2018, të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e disa pronave, në pronësi të Bashkisë Tiranë, të Njësisë Administrative Tiranë, me vendndodhje në zonat kadastrale 8350, 8230, 8360, 8250” të ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Në vendimin nr. 108, datë 25.10.2019 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e raportit përfundimtar të komisionit të negocimit i ngritur sipas vendimit nr.146, datë 15.11.2018 të Këshillit Bashkiak, dhe përcaktimin mbi kushtet dhe kriteret e shkëmbimit të ndërtesave në pronësi të Bashkisë Tiranë me subjektin zhvillues “Arlis Ndërtim” shpk dhe autorizimin e komisionit për përfshirjen në negocim të pasurive 1/190-nd dhe 1/158-nd”, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

*“Ngarkohet komisioni i negocimit për përfundimin e procedurës dhe përgatitjen e raportit përfundimtar brenda një afati prej jo më shumë se 45 ditësh, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi”.*

2. Ngarkohen Komisioni i Posaçëm i Negocimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR

TONI GOGU



## PASQYRA NR. 1

## NJË NDRYSHIM NË EMËRTIMIN E OBJEKTIT DHE TË FONDEVE TË AKORDUARA NË FORMËN E TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR NË KUADËR TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT BRENDA PROGRAMIT TË STREHIMIT LOKAL DHE URBANISTIKËS

Në Lekë

Nr.	Programi	Kap	Artikulli	Kodi Institucionit	Njesia shpenzuese	Kodi Projektit	Emërtimi i Objektit	Tipologji	Kosto e plotë	Plan viti 2020
							ISHTE			
							Aparati i Bashkisë		2.207.854.893	2.207.854.893
1.1	06140	1	231	2101001	Aparati i Bashkisë	1011925	Rindërtimi i shtëpive individuale në zonat e prekura nga tërmeti	Shpenzime Kapitale	2.207.854.893	2.207.854.893
							BEHET			
							Aparati i Bashkisë		1.839.879.078	1.839.879.078
2.1	06140	1	231	2101001	Aparati i Bashkisë	1011925	Rindërtimi i banesave individuale, ndërtimi dhe rikonstruksioni i infrastrukturës publike si dhe cdo ndërrhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të këtyre banesave	Shpenzime Kapitale	1.839.879.078	1.839.879.078